

# ZKM ALBANIA

4/2024



Notizie dalla Fondazione  
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO, Tirana

Lajme nga Fondacioni  
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË, Tiranë

Redaksia "ZKM ALBANIA" 📍 Kompleksi Spitalor Universitar "Zoja e Këshillit të Mirë" Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë  
📞 unikzkm 📧 unikzkm 🌐 www.unizkm.al / Per kontakti 📧 pr@fzkm.org

- 1993:** Themelohet në Tiranë Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë.
- 1995:** Poliambulanca Atë Luigji Monti fillon veprimtarinë.
- 2004:** Hapet Universiteti Katolik.
- 2008:** Hapet Qendra e Fizioterapisë dhe e Klinikës Dentare
- 2022:** Fillon misioni i Spitalit të ri Katolik ZKM.
- 2024:** ZKM Albania, me këtë revistë të përmuajshme rrëfjëmë histori dhe ushqejmë ideale.

Fondacioni ZKM ka nisur një proces lidhur me qëndrueshmërinë energjetike duke krijuar në Kompleksin universitar-spitalor të Tiranës një impiant fotovoltaiik për prodhimin e energjisë elektrike.

## ENERGJIA VJEN NGA QIELLI

Kjo është një përpjekje e rëndësishme ekonomike që synon gjithashtu të jetë një **zgjedhje etike** për mbrojtjen e mjedisit. Letra e famshme e Papa Françeskut -Laudato si', 2015 -përfaqëson tashmë një manifest që ndriçon praktikatat e mira. Kjo letër, së fundmi ka pasur një përditësim - Laudate Deum, 2023 – nëpërmjet të cilit Papa ka dashur të shpreh sërish **"shqetësimet serioze për kujdesin e shtëpisë sonë të përbashkët"**, domethënë tokës, duke hedhur poshtë "disa opinione përçmuese dhe të paarsyeshme" që shprehen kundër atyre që ngrenë thirrjen e alarmit për përkeqësimin e krizës klimatike. Një krizë, e cila - shprehet Papa - **"nuk është në të vërtetë një çështje që u intereson fuqive të mëdha ekonomike, të cilat janë të interesuara të marrin fitimin maksimal me koston më të ulët dhe në kohën më të shkurtër të mundshme"**. Papa Françesku e përfundon letrën e fundit me deklaratën se **"një qenie njerëzore që pretendon të zëvendësojë Zotin bëhet rreziku më i madh i vetes së tij"**. Konferenca e promovuar nga Fondacioni për në datë 22 Prill - me rastin e **Ditës botërore të tokës** - është një mundësi për të reflektuar mbi përgjegjësinë për trashëgiminë që do të lëmë pas nesh.

Prandaj edhe titulli i konferencës është domethënëse, **"Energjia vjen nga qielli"**, i cili ka një interpretim të dyfishtë: dielli është një burim energjie i rinovueshëm, por na kujton gjithashtu edhe dimensionin shpirtëror të jetës hyjnore që gjendet brenda nesh. Në këtë mënyrë do të jemi në gjendje të ndotim më pak, të konsumojmë në mënyrë të kujdesshme, të reduktojmë shpërdorimet ushqimore dhe të besojmë te "konvertimi ekologjik" duke krijuar kështu një kulturë të re për një botë më të drejtë: **"edhe nëse kjo nuk prodhon menjëherë një efekt shumë domethënës nga pikëpamja sasore, kontribuon gjithsesi në realizimin e proceseve transformuese që vijnë nga thellësia e shoqërisë"**, thekson Papa Françesku.

FONDAZIONE  
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

in collaborazione con  
DIPARTIMENTO DI ARCHITETTURA  
DELL'UNIVERSITÀ CATTOLICA NSBC

CONVEGNO

L'ENERGIA  
VIENE  
dal  
CIELO

per una  
CONVERSIONE  
ECOLOGICA

in occasione  
della  
Giornata Mondiale  
della Terra

22  
aprile  
2024

ORE  
10:00

COMPLESSO  
UNIVERSITARIO-OSPEDALIERO NSBC  
TIRANA (ALBANIA)



Dita e pranverës, 21 mars, një udhëtim në Zadrinë në zbulim të personazhit që i ka dhënë jetë ekonomisë.

## NË SHKOLLËN E ALTINIT

Studentët e Fakultetit ekonomik të Universitetit Katolik ZKM shkuan në Veri të Shqipërisë për t'u njohur me "mrekullinë" e Mrizit të Zanave, një krijim i Altin Prengës që është kthyer në një mit të gastronomisë me zero km dhe të ekonomisë së vendit. Altini, i cili pa hezitim e përkufizon veten si "fermer", ilustroi gjerësisht historinë e restorantit të tij, që është kthyer gjithashtu në një B&B, bulmetore, kantinë vere, fabrikë vaji dhe fermë. Për të arritur të gjitha këto, ai transformoi një burg të kohës së komunizmit dhe përfshiu shumë fermerë vendas. Me pak fjalë, një sipërmarrje e suksesshme, siç shkruan udhëzuesi për Shqipërinë, i publikuar nga Lonely Planet/EDT (2023): "Ky është ndoshta vendi më i mirë për të ngrënë në Shqipërinë e Veriut, pse jo dhe në të gjithë vendin. Është sigurisht i vetmi Convivium Slow Food në të gjithë Ballkanin. Nuk ka nevojë të rekomandosh ndonjë gjë në veçanti: çdo gjë është e shkëlqyer."



Dita e dyerve të hapura në Kampusin e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".



Më datë 13 prill, kampusi ynë multikulturor dhe ndërkombëtar priti qindra maturantë nga Shkodra, Vlora, Fieri, Lezha, Gjirokastra, Korça, Durrësi dhe Tirana, sigurisht që shumë prej tyre zgjodhën Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" për vitin e ri akademik 2024-2025. Të rinjtë u takuan dhe folën me pedagogë dhe koordinatorë të cilët shpjeguan me etikë dhe profesionalizëm gjithçka që nevojitet rreth programeve tona të studimit në *Ekonomi, Farmaci, Arkitekturë, Fizioterapi, Infermieristikë, Odontoiatri dhe Mjekësi*.





Dy ditë të rëndësishme.

## TË DIPLOMUARIT

Në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" u përmbyll me sukses dhe mes shumë emocionesh një rrugëtim i gjatë, i lodhshëm, i mbushur me sfida, por shumë i bukur dhe emocionues. Studentët tanë u diplomuan në Mjekësi, duke marrë në këtë mënyrë kualifikimin e mjekut. Ne në UKZKM jemi shumë krenarë për ju dhe e kemi ndjekur me vëmendje dhe përkushtim rrugëtimin tuaj.



Suksese mjekëve tanë të rinj **Katerina Baba, Renato Lamaj, Mario Dhano, Shesine Ndreu, Igli Llubani, Federica Vultaggio, Sindi Uruçi, Desara Plepi.**



Urimet më të mira për profesionistët tanë të rinj të odontiatrisë:  
**Lorenzo Beqiri,  
Rei Bircaj,  
Ascanio Rizzo,  
Diego Vella**

Përrurimi "Kopshtit të të Drejtëve" sollti një risi shumë të çmuar në Kampusin e Fondacionit dhe në opinionin publik shqiptar. Festë dhe pjesëmarrje, më datë 6 mars, në Tiranë. Dhe në këtë mënyrë lajmi u përhap në rrjetet sociale.

## KOPSHTI FLUTURON NË WEB

<https://unizkm.al/news/si-inaugura-il-primo-giardino-dei-giusti-in-albania>  
<https://www.aicu.it/giardino-dei-giusti-per-carlo-inaugurato-in-albania/>  
<https://it.gariwo.net/giusti/coraggio-civile/carlo-urbani-22783.html>



## NË PANAIR NË PRISHTINË



Në datat 16-17 prill 2024, Universiteti do të marrë pjesë në "Panairin e Arsimit" në Prishtinë, Kosovë. Për të përfaqësuar Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" do të jetë i pranishëm një grup i përbërë nga profesorë, koordinatore dhe Zyra e Promovimit dhe Marrëdhënieve me Publikun.



Rrugët midis historisë dhe spiritualitetit.

## UDHËTIMET NË KOSOVË DHE NË ITALI

Në fundjavë, pas përfundimit të sezonit dimëror të provimeve, studentët tanë u nisën në një udhëtim interesant në Kosovën tonë të bukur, ku eksploruan qytete historike, shijuan kuzhinën vendase dhe përjetuan aventura të paharrueshme në pistat e skisë në Brezovicë. Ishte një eksperiencë e pasur e cila e plotësoi pushimin e tyre pas provimeve me një copëz aventure dhe kulture.



Studentët tanë vizituan Romën, ku kryen një pelegrinazh kushtuar njohjes së historisë së këtij qyteti të jashtëzakonshëm. Studentët morën pjesë në audiencën e përgjithshme të Papa Françeskut dhe patën fatin të takojnë Atin e Shenjtë në një pritje të veçantë. Përveç Romës, studentët e UKZKM-së vizituan edhe Bazilikat e San Francesco-s dhe Santa Chiara-s në Assisi. Ky udhëtim ishte i rëndësishëm për të mësuar për forcën e besimit dhe për të nxitur harmoninë mes të rinjve.

Një fushatë promovimi është duke u zhvilluar për Spitalin e ri të Fondacionit ZKM.



**Spitali Katolik**  
Zoja e Këshillit të Mirë  
Përkushtuar Shëndetit Tënd

## SPITALI KATOLIK

Hapur në muajt e fundit të vitit 2022, Spitali Katolik është duke hyrë gradualisht në realitetin shqiptar, më shumë për arsye të cilësisë profesionale dhe teknologjike me të cilën është pajisur sesa nga informacioni lidhur me prezencën e tij operative në vend. Për këtë arsye u promovua një fushatë promovimi për shërbimet e shumta që ofrohen nga Spitali i cili mban emrin "Zoja e Këshillit të Mirë". Rrënjët e tij gjenden në historinë e gjatë të komunitetit fetar të themeluar nga Atë Monti në vitin 1857 në një spital të quajtur "Santo Spirito in Sassia" në Romë, më i vjetri në Evropë. Një traditë që vazhdon edhe sot në Shqipëri, edhe falë frymëzimit të Nënë Terezës.

## PERSONAZHI RAMAZAN

Njeriu që e do gjelbërimin dhe kujdeset për të.



Është një figurë që e përfaqëson Fondacionin tonë prej shumë vitesh, pasi e ka filluar shërbimin që në vitin 1996. Gjatë gjithë këtyre viteve ai është njohur me fetarët e Kongregatës dhe qindra punonjës të kampusit njëri pas tjetrit. Kishte një marrëdhënie "profesionale" me Atë Pierinon, nga i cili mësoi sekretet e rritjes së perimeve dhe të kujdesit për bimët zbukuruese. Ramazani mësoi gjithashtu... bazat e gjuhës italiane të fushës dhe ndihet i nderuar që është pjesë e botës sonë ZKM. Ramazani është një mik i të gjithëve, gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar të tjerët dhe të gjithë studentët në kampus.



**Festa fetare vjetore e "Zojës së Këshillit të Mirë" zhvillohet më datë 26 prill dhe kremtohet me solemnitet të veçantë në Shenjtëroren e Shkodrës.**

## **FESTA E FONDACIONIT**

Shenjtërorja është një dëshmi shekullore e besimit të krishterë dhe Kisha katolike e njeh atë si shenjtëroren kombëtare të Shqipërisë. Fondacioni ynë, i cili mban pikërisht titullin Zoja e Këshillit të Mirë - Maria, nëna e Jezusit - ka caktuar dy ditë festimesh në njëzet vjetorin e krijimit të institucionit të Universitetit.

Do të ketë dy momente kryesore:

- Pelegrinazhi i bashkëpunëtorëve të Fondacionit në Shkodër, të shtunën më datë **27 prill**
- Festa e Fondacionit, me prezantimin tradicional të bursave të studimit, të hënën më datë **29 prill**

Studentët, bashkëpunëtorët dhe miqtë e Fondacionit

janë të ftuar të përjetojnë këto dy ditë me intensitet të veçantë, në mënyrë që të rritet midis nesh vëllazëria universale dhe spirtualiteti, si dhe shtyllat e një jete të dimensionit njerëzor ashtu dhe hyjnor.



*Festa della Fondazione*

29 aprile 2024

COMPLESSO UNIVERSITARIO-OSPEDALIERO  
VNSC  
TIRANA (ALBANIA)

**Instituti Dermopatik Zoja e Papërlyer, i Romës drejt një marrëveshjeje bashkëpunimi me Spitalin Katolik të Tiranës.**

## **I.D.I. NË TIRANË**

Data zyrtare e aktiviteteve të para të IDI daton në vitin 1912, por që nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, fetarët e Atë Montit kryenin aktivitete përkujdesjeje ndaj sëmundjeve dermatologjike. Ndërkohë, IDZP është njohur si Instituti Shkencor i Hospitalizimit dhe Kujdesit për dermatologjinë, duke marrë dhe njohje ndërkombëtare. Ndërmjet IDZP-së dhe Fondacionit ZKM është duke u zhvilluar një marrëveshje bashkëpunimi dhe për këtë arsye rektori i Universitetit tonë, prof. Palombi, së fundmi bëri një vizitë në Spitalin e Romës.



**Klinika ofron një shërbim të çmuar shëndetësor që nga viti 2008, duke arritur rezultate të rëndësishme në fushën arsimore dhe**

## **ODONTOIATRIA KA BËRË RRUGË**

Fenomeni i cilësuar si "turizëm shëndetësor" drejt Shqipërisë është në rritje, veçanërisht për kujdesin dentar. Universiteti ZKM nëpërmjet fakultetit të tij të mjekësisë ka diplomuar tashmë 323 specialistë të rinj, duke kontribuar kështu në zhvillimin e këtij sektori të rëndësishëm të botës së kujdesit shëndetësor. Klinika jonë, tek e cila drejtohen pacientë të shumtë shqiptarë si dhe po rritet numri i atyre që vijnë nga jashtë funksionon prej 15 vitesh. Janë të shumta fushat e kujdesit: *implantologji, kirurgji, periodontologji, stomatologjia konservative, endodonci, ortodonci, pedodonci, proteza dentare.*

**Kontakte Tel: +355 4 2273 294 / E-mail: stomatologjia@fzkm.org**  
**Indirizzo: Rr. Dritan Hoxha, Tirana, Albania**



**ZKM**  
**ALBANIA**



# TAKIMET E ARDHSHME...

**FONDAZIONE NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO**  
in collaborazione con  
**DIPARTIMENTO DI ARCHITETTURA DELL'UNIVERSITÀ CATTOLICA NSBC**

**CONVEGNO**  
**L'ENERGIA VIENE dal CIELO**  
per una **CONVERSIONE ECOLOGICA**

in occasione della **Giornata Mondiale della Terra**

**22** aprile 2024  
ORE **10:00** | COMPLESSO UNIVERSITARIO-OSPEDALIERO NSBC TIRANA (ALBANIA)

**Programma**

**10.00 ACCOGLIENZA**

**10.10 INTRODUZIONE E SALUTO**  
Proiezione spezzone docufilm "La lettera"  
**Fr. Ruggero Valentini**  
Presidente Fondazione NSBC

**10.30 INTERVENTI**  
Modera **P. Binu Peediyekal**  
**Papa Francesco e l'ecologia integrale**  
**Mons. Gjergji Meta**  
Presidente Conferenza Episcopale Albanese  
**Una politica per la "Casa comune": orientamenti e strategie in Albania**  
**On.le Eduard Shalsi**  
Presidente Commissione Parlamentare Economia e Finanza  
**I pilastri antropologici ed etici del progettare e del pianificare**  
**Prof. Giuseppe De Luca**  
Docente Dipartimento di architettura

**11.40 ESPERIENZE**  
**L'impianto fotovoltaico della Fondazione NSBC**  
**Arch. Alfons Shtjefni, Arch. Claudio Radice**  
Società Albesol, Tirana

**12.00 SALUTO CONCLUSIVO**  
**Arch. Andia Guga**  
Dipartimento di Architettura UCNSBC

**20** UNIVERSITÀ CATTOLICA NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO  
Da vent'anni in Europa

**GIORNATA DELL'EUROPA**

📅 09 maggio 2024

**20** CATHOLIC UNIVERSITY OUR LADY OF GOOD COUNSEL  
Twenty years in Europe

**CESPIC**  
European Centre of Peace Science  
Empire and Cooperation

**Roots of War & Establishment of a Lasting Peace**

September 3-10<sup>th</sup> 2024

UNIVERSITETI KATOLIK  
KOMPLEKSI SPITALOR UNIVERSITETI

**SUMMER SCHOOL**  
9<sup>th</sup> edition

**20** UNIVERSITÀ CATTOLICA NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO  
Da vent'anni in Europa

**CAMBIAMENTI CLIMATICI MARE SALUTE**

23 MAGGIO 2024